

Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit zhvilloi një takim me Këshillin Studentor të Universitetit, me synim forcimin e bashkëpunimit dhe komunikimit të vazhdueshëm me studentët.

Gjatë takimit, studentët u njohën me funksionet dhe detyrat që ofron Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit, duke u informuar mbi rolin e saj në mbështetjen e studentëve në aspektin akademik dhe profesional. Në fokus të diskutimeve ishin gjithashtu shqetësimet dhe problematikat që hasin studentët gjatë jetës universitare, si dhe nevojat e tyre për orientimin dhe zhvillimin profesional.

Takimi shërbeu si një hapësirë e hapur bashkëbisedimi mbi çështje që lidhen me përmirësimin e jetës akademike dhe studentore, si dhe me ndërgjegjësimin e studentëve mbi rëndësinë e edukimit, planifikimit dhe ndërtimit të karrierës së tyre.

Aktiviteti u zhvillua në një atmosferë bashkëpunuese dhe mirëkuptimi, duke kontribuar në forcimin e urave të mëtejshme të bashkëpunimit ndërmjet studentëve dhe Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit.

